

Elona Hoxhaj

Mban pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme për të Drejtën e Informimit pranë Zyrës së Komisionerit që prej muajit gusht 2021. Znj. Hoxhaj është pjesë e stafit të Zyrës së Komisionerit që prej marsit të vitit 2020 dhe është diplomuar si juriste pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2007, ndërsa ka kryer Masterin Shkencor në “Të drejtën kushtetuese të krahasuar dhe evropiane” në po të njëjtin Universitet.

Në karrierën e saj profesionale, ajo ka mbajtur pozicione të ndryshme në administratën publike dhe në sektorin privat, si: Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit pranë Zyrës së Komisionerit; Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Rendin dhe Sigurinë Publike në Ministrinë e Brendshme; Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme; Drejtor i Përgjithshëm pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit pranë Agjencisë së Prokurimit Publik; avokate pranë studios ligjore “Boga & Associates”, etj.

Znj. Hoxhaj është e angazhuar edhe në mësimdhënie që prej vitit 2017, si lektore e “Të drejtës kushtetuese”, “Të drejtës administrative”, “Të drejtës së autorit”, etj. Është anëtare e Dhomës së Avokatisë që prej vitit 2010.